



Prishtinë: 30.03.2011

Kodi i ZRRE-së: V_355_2011

Nr.i Referencës: ZRRE/DMK_V_514_01_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
4. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
5. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_514_01_11**;
6. Apelimi i konsumatorit me datë 02.02.2011;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET pjesërisht apelimi i konsumatorit Muhamed Shehu (shifra e konsumatorit DGL – 6946) nga Gjilani, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së me datë 28.04.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 12.04.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 15.04.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit, ku kanë konstatuar se konsumatori keqpërdor energjinë elektrike duke vendosur shiritin filmik në anën e majtë me ç'rast ka penguar rrotullimin e diskut si dhe ka udhëzuar konsumatorin që të bëjë ndërrimin e njehsorit elektrik brenda tri ditëve. Ekipi ka evidentuar po ashtu se si evidencë marrin shiritin filmik.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 081345 datë 15.04.2008
- Me datë 30.04.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DGL08HP01467 në vlerë prej 2,247.88 €. **Provë:** Fatura DGL08HP01467 e datës 30.04.2008
- Me datë 03.03.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike. **Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK, datë 03.03.2010
- Me datë 12.04.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe kalibrimit. **Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 12.04.2010



- Me datë 28.04.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 28.01.2011, DMK duke u bazuar në analizat e bëra lëndës së konsumatorit ka lëshuar vendimin nr. ZRR/DMK_V_514_01_11 duke refuzuar ankesën e konsumatorit si të pabazë.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_514_01_11 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Por duke pasur për bazë shpenzimet e energjisë elektrike si dhe mesataret e shpenzimeve të energjisë elektrike të konsumatorit konstatohet se konsumatori ka ndryshim të shpenzimit të energjisë me njehsor të ri, por që konsumatori ngarkohet me rikthim të humbjeve bazuar në shpenzimin më të madh mujor me njehsor të ri për periudhën një vjeçare (05/2008 – 04/2009) në vlerë **952 kWh/muaj**. Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë pjesërisht** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së obligon KEK-un që:

1. Shkarkon konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DGL08HP01467 në vlerë prej 2,247.88 €.
2. Ngarkoj konsumatorin me faturë të rikthimit të humbjeve për periudhën një vjeçare (05/2007 – 04/2008) bazuar në shpenzimin mujor **952 kWh/muaj**.
3. Pas rikalkulimit të bërë ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthim i humbjeve), sipas pikave të cekura më lart, duhet të njoftoj ZRRE-në për këtë rikalkulim

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar